

VENDIM
Nr. 51, datë 17.2.2000

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.248, DATË 25.3.1996, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT DHE KATEGORISË SË
TELEFONAVE CELULARË, NË PËRDORIM TË INSTITUCIONEVE
BUXHETORE”

(Ndryshuar me VKM nr. 477, datë 31.8.2000)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 248, datë 25.3.1996, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në tabelën “Numri i telefonave celularë për institucionet buxhetore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhen këto ndryshime:

a) Në nr.2, në institucionin “Këshilli i Ministrave”, fjalët “ministri i Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik” shfuqizohen.

b) Pas nr.2, shtohet nr.2/1, me fjalët “Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë,

- Ministri.....1

- Zëvendësministri..... 1.”.

2. Në pikën 3, pas fjalëve “Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shtohen fjalët “Zëvendëskryetarët e Kuvendit”.

3. Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“Për të gjithë funksionarët, të cilët gëzojnë të drejtën për t’u pajisur me telefon celular të përhershëm, me përjashtim të atyre të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi dhe të sekretarëve të përgjithshëm në Presidencë, Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave, kufiri i shpenzimeve për këtë lloj shërbimi të mos e kalojë shumën 15 mijë lekë në muaj.

Shpenzimet e tjera mbi këtë shumë përballohen nga përdoruesit”.

I hiqet kufiri i shpenzimeve të përballueshme nga buxheti i shtetit, për përdorimin e telefonit celular edhe zëvendësministrit të Rendit Publik, drejtorit të Kabinetit të Kryeministrit, drejtorit të Departamentit të Informacionit, në Këshillin e Ministrave, drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe drejtorit të Policisë Kriminale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta